



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr.06 /2025

Datë:.16.01.2025

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1, dhe nenin 71, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenin 13 (paragrafi 3, nënparagrafi 3.1) të Rregullores Nr. 04/2022 për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të ankesës me nr. të protokollit 1147 të dt. 17.12.2025, të parashtruar nga subjekti i të dhënave z. A.A, ndaj z. B.B, kontrollues, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër të protokollit 1147, e datës 17.12.2025, e parashtruar nga subjekti i të dhënave ndaj z. B.Bala, kontrollues.
2. Urdhërohet z. Berat Buzhala, në cilësinë e kontrolluesit, të anonimizoj/fshij, numrin e telefonit të subjektit të të dhënave z. AA, të publikuar më datë 14.12.2024, në platformën personale në Facebook.
3. Urdhërohet kontrolluesi, të ndaloj shpërndarjen e të dhënave personale (numrin e telefonit), pa bazë ligjore, (pëlqimin paraprak), të subjektit të të dhënave.
4. Obligohet kontrolluesi, që brenda tetë (8) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të njoftojë Agjencinë për veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e pranimimit.

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia) ka pranuar ankesë, më datë 17.12.2024, nga subjekti i të dhënave z. A.A, e cila mbanë numrin e prot. 1147, në të cilën pala ankuese shpreh shqetësimin se, z. B.B, në profilin e tij personal të platformës Facebook më datë 14.12.2024, ka publikuar bisedën private të realizuar ndërmjet ankuesit dhe z, Buzhala, duke përfshirë edhe numrin e telefonit, pa pëlqimin paraprak të tij. Gjithashtu i njëjti ka, ka krijuar një grup në WhatsApp, ku ka përfshirë numrin e telefonit të subjektit të të dhënave, duke ekspozuar atë

ndaj individëve të tjerë, prej të cilëve subjekti i të dhënave, ka pranuar mesazhe tallëse dhe denigrues.

Agjencia bazuar në autorizimet ligjore, përmes zyrtarit të inspektimit, ka filluar procedurën e shqyrtimit të ankesës për të vërtetuar pretendimet e palës ankuese. Si fillim, zyrtari i inspektimit, më datë 23.12.2024, iu është drejtuar kontrolluesit, përmes postës elektronike, të cilin e ka njoftuar me ankesën si dhe nga i njëjti ka kërkuar ta njoftojë Agjencinë brenda afatit tre ditor se, cili është qëllimi i publikimit të bisedës së bashku me numrin e telefonit të subjektit të të dhënave. Meqë deri më datë 16.01.2025, kontrolluesi, nuk është përgjigjur në kërkesën e Agjencisë, Agjencia ka vazhduar shqyrtimin e ankesë duke u bazuar në LMDhP-në. Meqë profili personal në platformën “Facebook” i z. Buzhala, është publik, zyrtari i inspektimit ka hulumtuar për të vërtetuar pretendimet e palë ankuese. Pas hulumtimit të bërë në profilin personal në platformën sociale “Facebook” të z. Buzhala, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave, është konstatuar se, më datë 14.12.2024, kontrolluesi ka publikuar komunikimin e bërë me subjektin e të dhënave, përmes platformës WhatsApp. Në përmbajtjen e komunikimit të publikuar, është konstatuar se nuk ka përpunim të të dhëna personale, mirëpo, kontrolluesi së bashku me përmbajtjen ka publikuar edhe numrin personal të telefonit të subjektit të të dhënave (ankuesit).

LMDhP në nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, ka dhënë përkufizimi i shprehjes “kontrollues i të dhënave”, me të cilin nënkuptohet se kontrollues i të dhënave është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale. Andaj, sipas këtij përkufizimi, z. B.B, në këtë rast cilësohet kontrollues i të dhënave.

LMDhP, përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të LMDhP-së, me **të dhëna personale** nënkuptohet çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues *online*, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, publikimi i të dhënave personale nënkupton përpunim të të dhënave. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, ligji, në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të LMDhP-së, përcakton se me **përpunim** nënkuptohet çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Në kuptimin e kësaj dispozite çdo e dhënë nga e cila mund të identifikohet një person fizik, cilësohet e dhënë personale, dhe përdormi i këtyre të dhënave nënkupton përpunim të të dhënave personale.

Sipas nenit 3, paragrafit 1, nën paragrafit 1.2 të LMDhP-së, përpunim i të dhënave është çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Siç mund të kuptohet nga ky përkufizim edhe publikimi i të dhënave konsiderohet përpunimi i të dhënave personale, dhe si i tillë duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme.

LMDhP në neni 4, ka paraparë parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale, e një nga parimet e para të përpunimit është parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës ku sipas të cilit, të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Pra, si parim shumë i rëndësishëm është ligjshmëria e përpunimit. por kjo nuk nënkupton se parimet tjera kanë më pak rëndësi por vetëm se me rastin e përpunimit të të dhënave personale si fillim duhet të shikuar ligjshmëria e përpunimit pastaj pasojnë parimet tjera me radhë siç janë: parimi i kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave, parimi i kufizimit të ruajtjes së të dhënave si dhe parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit.

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDHP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në harmoni me ligjin. Sipas nenit 5, paragrafi 1 të LMDHP-së, përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën njëri nga kriteret si në vijim: 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike; 1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës; 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi; 1.4. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë; 1.5. nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit; 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë.

Kushtetuta e Kosovës si akti më i lartë juridik, në nenin 40, ka garantuar lirinë e shprehjes, sipas të cilës, liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Për gazetarë dhe media, liria e shprehjes është e rëndësishme për shkak të rolit të tyre në informimin e publikut.

Bazuar në një peshim të mbrojtjes së të dhënave personale, kundrejt të drejtës së lirisë së shprehjes, në këtë rast komunikimit i bërë WhatsApp dhe i publikuar në platformën personale

Facebook, të kontrolluesit, nuk paraqet cenim të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale të përcaktuar me LMDhP-në, pasi që përmbajtja e komunikimit nuk përmban të dhëna personale që mund të sjell deri tek shkelja e LMDhP-së. Me këtë rast Agjencia, konsideron se kontrolluesi i të dhënave, ka plotësuar kriterin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, të cilin e ka bazuar në nenin 5, të LMDHP-së, (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5), i cili përcakton se përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm, nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik.

Mirëpo, përveç parimit të ligjshmërisë drejtësisë dhe transparencës, të paracaktuara në nenin 4, të LMDhP-së, kontrolluesi duhet të jetë në gjendje të zbatoj njëkohësisht edhe parimet e tjera të përcaktuara në këtë nen, që në rastin konkret, me publikimin të komunikimit me subjektin e të dhënave në platformën personale Facebook, ka publikuar edhe numrin e telefonit të subjektit të të dhënave, kontrolluesi nuk ka respektuar parimin e minimizimit të të dhënave të përcaktuar në nenin 4, paragrafi 3 të LMDhP-së, pasi që numri i telefonit personal, të subjektit të të dhënave, nuk konsiderohet si çështje që i shërben interesit publik. Ky parim kërkon që të identifikohen sasi minimale të të dhënave personale që janë të nevojshme për të përmbushur qëllimin e publikimit.

Andaj, nga kjo që u tha më lartë, bazuar në faktet e sipërpërmendura si dhe LMDhP-në, Agjencia konstaton se kontrolluesi duke mos anonimizuar të dhënat e tepërta në komunikimin e publikuar më datë 14.12.2024, në platformën personale Facebook, në këtë rast, numrin e telefonit personal, ka përpunuar të dhëna personale në kundërshtim me neni 4 paragrafi 3, dhe nenin 5 të LMDhP.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas inspektimit të kryer dhe vërtetimit të gjendjes faktike, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 16.01.2025]

Zyrtare për Inspektim

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z. B.B, kontrollues,
- Palës ankuuese,
- Arkivit të Agjencisë.